



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E MBIKËQYRJES NË FUSHËN E DREJTËSISË PENALE DHE
SIGURISË PUBLIKE

Nr. 25/6 prot.

Tiranë, më 25.02.2025

REKOMANDIM

Nr. 03, datë 25.02.2025

PËR KONTROLLUESIN “QENDRA PSIKO-SOCIALE VATRA”

Në mbështetje të neneve 29, 30, 31 dhe 32 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar (në vijim, “Ligji”), neneve 77-112 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” (në vijim, “Kodi i Procedurave Administrative”), si dhe provave të administruara në ngarkim të Kontrolluesit “Qendra Psiko-Sociale Vatra” (në vijim, “Kontrolluesi ose Qendra”)

KONSTATOVA SE:

Në zbatim të Urdhrit nr. 02, datë 07.01.2025 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim, “Komisioneri”), u krye hetimi administrativ pranë Kontrolluesit, me objekt:

- *Zbatimi i ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar dhe akteve të miratuara nga Komisioneri në lidhje me mbledhjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale, gjatë kryerjes së aktivitetit nga Kontrolluesi.*

Komisioneri, pasi shqyrtoi relacionin e hetimit administrativ, procesverbalin e konstatimit dhe provat e administruara gjatë ushtrimit të hetimit pranë Kontrolluesit, vëren se:

1. Qendra “Psiko-Sociale Vatra” është një organizatë jofitimprurëse, e regjistruar në regjistrin e OJF-ve, me Vendimin nr. 211, datë 17.01.2005, të Gjykatës së Shkallës së Parë të Rrethit Gjyqësor, Tiranë.

Kontrolluesi ushtron veprimtarinë e tij, si organizatë jofitimprurëse, e cila ofron shërbime të kualifikuara psikologjike dhe sociale për mbrojtjen dhe riintegrimin e viktimave të trafikimit, si dhe kontribuon në sistemet e identifikimit, referimit,

studimit, sensibilizimit, parandalimit dhe ndihmës ndaj këtij grupi dhe grupeve të tjera, në rrezik trafikimi.

Kontrolluesi, bazuar në VKM nr. 582, datë 27.07.2011 *“Për miratimin e Procedurave Standarde të Veprimit për Identifikimin dhe Referimin e Viktimave/Viktimave të Mundshme të Trafikimit”*, legjitimohet të përpunojë të dhënat personale të Viktimave të Trafikimit dhe Viktimave të Mundshme të Trafikimit, të identifikuar me termin *“përfitues”*.

Kontrolluesi, në funksion të veprimtarisë së tij, përpunon të dhëna personale dhe të dhëna sensitive, pjesë të dosjeve të përfituesve nga programet dhe shërbimet e përkujdesit shoqëror, në qendrat rezidenciale, për përfituesit.

Qendra përpunon të dhëna personale, sipas kategorive: *“Emër”, “Atësia”, “Mbiemër”, “Data e lindjes”, “Nr. i identifikimit”, “Gjinia”, “Vendlindja”, “Shtetësia”, “Adresa”, “Gjendja Civile”, “Formimi profesional”, “Diploma, certifikata”, “Të dhëna ekonomike dhe financiare”*, si dhe të dhëna sensitive, të tilla si: *“Kartela shëndetësore”, “Rraca/etnia”, “Gjendja penale”*.

Përpunimi i të dhënave kryhet në mënyrë manuale dhe elektronike, të administruara në format *“excel”*. Popullimi i databazës elektronike me të dhënat personale të mësipërme, realizohet nga personi përgjegjës, i cili ka akses, me anë të një kodi të dyfishtë që lejon hyrjen në të dhënat e ruajtura në mënyrë elektronike.

2. Kontrolluesi ka vënë në dispozicion të grupit të hetimit administrativ, rregulloren *“Për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale”*. Konstatohet se, në pikën 5, të nenit 18, të rregullores së mësipërme, përcaktohet se të dhënat e përfituesve ruhen për një periudhë 10 vjeçare, nga dita e daljes nga ky program.

Megjithatë, gjatë hetimit administrativ në terren dhe verifikimet e kryera në ambientet e zyrës së arkivit, rezulton se, Kontrolluesi mban dhe ruan në dosje, dokumente që përmbajnë të dhëna personale të përfituesve, përtej afatit 10 vjeçar të përcaktuar në rregulloren *“Për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale”*, pa argumentuar dhe dokumentuar nevojën për administrimin e tyre përtej këtij afati.

Për sa më sipër, Zyra e Komisionerit vlerëson se, Kontrolluesi nuk ka marrë masa lidhur me administrimin e dokumentacionit për aq kohë sa është i nevojshëm për qëllimin për të cilin është grumbulluar, si dhe nuk ka respektuar afatet e sipërpërmendura, në kundërshtim me parashikimet e germës *“d”*, të pikës 1, të nenit 5, të Ligjit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, lidhur me kategoritë e të dhënave të grumbulluara, në funksion të ushtrimit të veprimtarisë së tij, Kontrolluesi duhet të parashikojë mbajtjen e të dhënave personale të grumbulluara në atë formë, që lejon identifikimin

për një kohë të caktuar, por jo më tepër se sa është e nevojshme për të përmbushur qëllimin për të cilin të dhënat janë grumbulluar.

Koha e ruajtjes së të dhënave personale duhet të përcaktohet nga Kontrolluesi, në përputhje me parashikimin e gremës “d”, të pikës 1, të nenit 5, të Ligjit. Gjithashtu, në momentin e përfundimit të qëllimit të përpunimit, Kontrolluesi duhet të realizojë shkatërrimin e këtyre të dhënave, pasi përpunimi i mëtejshëm i tyre konsiderohet i paligjshëm.

3. Konstatohet se, referuar pikës 2 dhe 3, të nenit 14, të rregullores “Për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale”, përcaktohet se, përgjegjësjë e strehëzës administron një kopje për të gjitha të dhënat dhe “software”-t që mbahen ose ruhen në kompjuterat e përdorur nga pjestarët e stafit. Gjithashtu, përcaktohet se kopja dublikatë ruhet në një ambient të sigurt dhe të ndryshëm nga godina aktuale.

Për këtë arsye, Zyra e Komisionerit vlerëson se, është i nevojshëm rishikimi i këtij akti, ku të parashikohen rregulla dhe procedura organizative specifike mbi mënyrën e administrimit dhe ruajtjes së kopjes dublikatë të këtyre të dhënave, si dhe ambientet përkatëse në të cilat do të mbahen këto të dhëna, me qëllim garantimin e sigurisë së tyre, në përputhje me nenin 27 të Ligjit.

4. Konstatohet se, në pikën “e”, të nenit 15, të rregullores “Për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale”, përcaktohet se ambientet e hyrjes në strehëz, survejohen me kamera gjatë 24 orëve.

Për sa më sipër, gjatë hetimit administrativ në terren, konstatohet se, Kontrolluesi ushtron veprimtarinë në dy ambiente, përkatësisht selia dhe strehëza. Nga verifikimet e kryera, rezulton se në rrethimin e jashtëm të strehëzës, është e vendosur vetëm një kamerë e integruar në portën hyrëse të godinës, në një kënd, prej të cilit nuk sigurohet fushëpamja e duhur, me qëllim të sigurimit të kontrollit mbi hyrjet dhe daljet nga ambientet e Kontrolluesit, ku administrohen të dhëna personale të përfituesve dhe stafit. Zyra e Komisionerit vlerëson se, niveli i sigurisë së ambienteve fizike duhet të jetë i përshtatshëm me natyrën e përpunimit dhe kategoritë e të dhënave personale dhe sensitive, të cilat përpunohen nga Qendra.

Për rrjedhojë, rezulton se, Kontrolluesi nuk ka marrë masa organizative dhe teknike të përshtatshme e të mjaftueshme, për të mbrojtur të dhënat personale që administrohen, nga shkatërrime të paligjshme, humbje aksidentale, për të mbrojtur aksesin ose përhapjen nga persona të paautorizuar, në kundërshtim me parashikimet e nenit 27 të Ligjit dhe Udhëzimit nr. 47 të Komisionerit, datë 14.09.2018 “Për përcaktimin e rregullave për ruajtjen e sigurisë së të dhënave personale të përpunuara nga subjektet përpunuese të mëdha” (në vijim, “Udhëzimi nr. 47”).

5. Konstatohet se, Kontrolluesi, për të miturit, që trajtohen nga Kontrolluesi si shoqërues të subjektit përfitues (foshnjët e lindura nga viktimat e trafikimit/viktimat e

mundshme të trafikimit), nuk identifikohen në rregullore, si dhe për këtë kategori nuk janë hartuar rregulla dhe procedura organizative specifike mbi mënyrën e përpunimit të të dhënave personale, sigurinë e të dhënave, konfidencialitetin, afatet e mbajtjes së të dhënave, nivelet e aksesit etj., si një detyrim shumë i rëndësishëm, në zbatim të nenit 27 të Ligjit, pasi shmanng pasojat e rënda që mund të vijnë për subjektet e të dhënave.

Të dhënat sensitive, të administruara nëpërmjet kartelave dhe çdo dokumentacioni tjetër shëndetësor, ruhen në ambientet e zyrës së arkivit, duke mos marrë, midis të tjerash, masa organizative dhe fizike, si një kategori e veçantë, të cilës duhet t'i sigurohet mbrojtje e dyfishtë dhe vëmendje e shtuar për të garantuar mbrojtjen dhe sigurinë e tyre, në përputhje me nenin 27 të Ligjit, si dhe nenit 5 dhe 8 të Udhëzimit nr. 49, datë 02.03.2020 të Komisionerit “Për mbrojtjen e të dhënave personale shëndetësore” (në vijim, “Udhëzimi nr. 49”).

Zyra e Komisionerit vlerëson se Kontrolluesi është i detyruar të marrë masa sigurie, sipas nenit të 27 Ligjit, për mbrojtjen e të dhënave personale të foshnjeve dhe përfituesve, duke i kushtuar vëmendje të veçantë të dhënave sensitive.

Kontrolluesi duhet të hartojë rregulla dhe procedura organizative specifike për këtë kategori të të dhënave personale, në lidhje me mënyrën e përpunimit dhe sigurinë e këtyre të dhënave. Të dhënat sensitive duhet të ruhen të ndara nga çdo e dhënë tjetër personale që gjendet në Qendër, duke vendosur rregulla të posaçme të dedikuara mbrojtjes së të dhënave sensitive të foshnjeve të lindura nga viktimat e trafikimit/viktimat e mundshme të trafikimit, në përputhje me nenin 27 të Ligjit, si dhe nenit 5 dhe 8 të Udhëzimit nr. 49 të Komisionerit.

6. Kontrolluesi ka vendosur në dispozicion të grupit të hetimit administrativ, “*Politikat dhe procedurat e mbrojtjes së të dhënave personale*”, në të cilën parashikon rregulla të përgjithshme mbi proceset përpunuese që kryen gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij, pa përcaktuar në mënyrë konkrete kategoritë e të dhënave personale, rregulla specifike mbi mënyrën e përpunimit të të dhënave, sigurinë e të dhënave, të drejtat e subjekteve, etj., sipas parashikimeve të nenit 27 të Ligjit, me qëllim garantimin e përpunimit të ligjshëm dhe sigurisë së të dhënave, në përputhje me proceset përpunuese të Kontrolluesit, në kundërshtim me parashikimet e nenit 27 të Ligjit dhe Udhëzimin nr. 47 të Komisionerit.

Nga analizimi i aktit të mësipërm dhe provave në tërësi, konstatohet se, Kontrolluesi nuk ka kryer Analizë Risku, duke kryer një vlerësim të ndikimit të proceseve përpunuese në mbrojtjen e të dhënave personale, me qëllim evidentimin e risqeve gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij, në përpunimin e të dhënave personale të subjekteve të të dhënave për shkak të natyrës, shtrirjes ose qëllimit të tyre, në kundërshtim me nenin 27 të Ligjit dhe Udhëzimit nr. 47 të Komisionerit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, është e domosdoshme që Qendra, të hartojë një Analizë Risku mbi të Dhënat Personale, e cila duhet të përmbajë një vlerësim të plotë

dhe të detajuar të rreziqeve që mund të ndodhin gjatë procesit të përpunimit të të dhënave, duke identifikuar çfarë mund të csnojë të drejtat e subjekteve të të dhënave, në veçanti në lidhje me sigurinë e informacionit dhe mbrojtjen e të dhënave personale në përputhje me nenin 27 të Ligjit dhe Udhëzimit nr. 47 të Komisionerit.

7. Kontrolluesi ka nënshkruar një kontratë shërbimi me “*Illyrian Guard*” sh.a., me objekt: “*Shërbim sigurie për ruajtjen fizike të ndërtesave, asetëve dhe njerëzve të Qendra Psiko-Sociale Vatra me punonjës shërbimi*”.

Nga analizimi i kontratës së shërbimit, vërehet se, parashikohet vetëm një pikë (*pika 11.1*), ku palët bien dakord që ofruesi i shërbimit është përgjegjës për çdo humbje ose dëm që mund t’i shkaktohet Kontrolluesit, nga veprimet ose mosveprimet e tij.

Nga shqyrtimi i nenit të mësipërm dhe kontratës në tërësi, Zyra e Komisionerit vlerëson se, nuk janë reflektuar në mënyrë të plotë, rolet, detyrimet dhe përgjegjësitë mes kontrolluesit dhe përpunuesit, sipas parashikimeve të nenit 20 të Ligjit dhe përcaktimeve të Udhëzimit nr. 19, datë 03.08.2012 të Komisionerit “*Mbi rregullimin e marrëdhënieve mes kontrolluesit dhe përpunuesit në rastet e delegimit të përpunimit të të dhënave dhe përdorimit të një kontrate tip në rastet e këtij delegimi*”, i ndryshuar (në vijim, “*Udhëzimi nr. 19*”).

Zyra e Komisionerit vlerëson se, të gjitha detyrimet e sanksionuara në nenin 20 të Ligjit dhe Udhëzimit nr. 19, duhet të jenë të përfshira në kontratën dhe/ose aneks kontratën e hartuar dhe nënshkruar mes kontrolluesit dhe përpunuesit. Çdo kontratë përpunimi (outsourcing), që ka për qëllim delegimin e përpunimit të të dhënave personale duhet të përmbajë dispozita që vendosin rregulla për përpunimin e të dhënave personale, sipas legjislacionit në fuqi. Çdo kontratë e tillë duhet të parashikojë masat që duhet të marrë përpunuesi për të siguruar/garantuar mbrojtjen e mjaftueshme të të dhënave, si dhe hapat që do të ndërmerren në rast cenimi të të dhënave, me qëllim që të sigurojë paprekshmërinë e tyre, në çdo hallkë të këtij përpunimi.

8. Gjithashtu, konstatohet se, Kontrolluesi nuk ka marrë masa në kuadër të trajnimit të punonjësve që kanë akses dhe përpunojnë të dhëna personale, lidhur me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale, në kundërshtim me Udhëzimin nr. 47 të Komisionerit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, bazuar në Kreun IV, të Udhëzimit nr. 47, Kontrolluesi duhet të marrë masa konkrete në kuadër të trajnimit të punonjësve që kanë akses dhe përpunojnë të dhëna personale, bazuar në legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Trajnimet në lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale, duhet të jenë të vazhdueshme dhe të përshtatura sipas nevojave dhe proceseve të punës së Kontrolluesit dhe legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale, me qëllim ndërgjegjësimin e punonjësve, të cilët për shkak të proceseve të punës, janë të ngarkuar për përpunimin e të dhënave personale.

Në përfundim të hetimit administrativ, referuar provave dhe konstatimeve në vend, grupi i hetimit administrativ hartoi procesverbalin përkatës, një kopje e të cilit i është dërguar Kontrolluesit me rrugë postare.

Në respektim të së drejtës për t'u dëgjuar, në zbatim të neneve 87-89 të Kodit të Procedurave Administrative, Kontrolluesi është ftuar të marrë pjesë në seancë dëgjimore, përpara marrjes së vendimit përfundimtar nga ana e Komisionerit.

Përfaqësuesja e Kontrolluesit është paraqitur në seancën dëgjimore, të datës 18.02.2025, të organizuar nga Zyra e Komisionerit, gjatë së cilës ka paraqitur pretendimet me shkrim nëpërmjet shkresës nr. 488 prot., datë 14.02.2025, si dhe ka deklaruar angazhimin për rikuperimin e shkeljeve të konstatuara gjatë hetimit administrativ.

Në përfundim, Zyra e Komisionerit vlerëson bashkëpunimin e Kontrolluesit me grupin e kontrollit, gjatë ushtrimit të hetimit administrativ, si dhe angazhimin e tij për të rikuperuar shkeljet e konstatuara. Plotësimi i këtyre detyrimeve nga ana e Kontrolluesit është mjaft i rëndësishëm pasi garanton përpunimin e ligjshëm, sigurinë e të dhënave personale dhe shmang mundësinë e përhapjes së tyre në mënyrë të paligjshme.

PËR KËTO ARSYE:

Në zbatim të neneve 5, 20, 27, 29, 30, 31 (pika 1, germa "a/1"), si dhe 32 të Ligjit,

REKOMANDOJ:

1. Kontrolluesi, të marrë masa për mbajtjen e dokumentacionit për aq kohë sa është i nevojshëm, për qëllimin për të cilin është grumbulluar duke respektuar afatet e përcaktuara, në përputhje me parashikimet e germës "d", të pikës 1, të nenit 5, të Ligjit. Në momentin e përfundimit të qëllimit të përpunimit, Kontrolluesi duhet të realizojë shkatërrimin e këtyre të dhënave, pasi përpunimi i mëtejshëm i tyre konsiderohet i paligjshëm;
2. Kontrolluesi, të marrë masa për të rishikuar marrëveshjet e bashkëpunimit me përpunuesit, duke specifikuar rolet, përgjegjësitë dhe detyrimet midis palëve, sipas dispozitave të parashikuara në nenin 20 të Ligjit dhe Udhëzimin nr. 19 të Komisionerit;
3. Kontrolluesi, në zbatim të nenit 27 të Ligjit, të marrë masa për përfshirjen në "*Rregulloren për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale*", të rregullave dhe procedurave organizative specifike mbi mënyrën e përpunimit të të dhënave personale dhe të dhënave sensitive, masat e sigurisë se të dhënave, nivelet e aksesit në të dhënat personale sipas proceseve përpunuese, mënyrat e përpunimit të të dhënave, të drejtat e subjekteve të të dhënave, garantimin e konfidencialitetit etj., në funksion të aktivitetit të tij, për çdo proces përpunimi;
4. Kontrolluesi të marrë masa për hartimin e rregullave dhe procedurave organizative specifike për të dhënat sensitive, në lidhje me mënyrën e përpunimit dhe sigurinë e

këtyre të dhënave, si dhe të vendosë rregulla të posaçme për mbrojtjen e të dhënave sensitive të subjekteve shoqëruese dhe viktimave të trafikimit/viktimat e mundshme të trafikimit, në përputhje me nenin 27 të Ligjit dhe Udhëzimin nr. 49 të Komisionerit;

5. Kontrolluesi, të marrë masa për hartimin e Analizës së Riskut në të Dhënat Personale, gjatë ushtrimit të veprimtarisë, me qëllim evidentimin e rasteve që mund të cenojnë konfidencialitetin, integritetin dhe disponueshmërinë e të dhënave personale, sipas parashikimeve të nenit 27 të Ligjit dhe Udhëzimin nr. 47 të Komisionerit;
6. Kontrolluesi, me qëllim garantimin e sigurisë së të dhënave personale, duhet të zbatojë detyrimet e përcaktuara në Udhëzimin nr. 47, lidhur me trajnimin e punonjësve që kanë akses dhe përpunojnë të dhëna personale, në përputhje me proceset përpunuese që ata kryejnë gjatë veprimtarisë së tyre;
7. Në zbatim të pikës 1, të nenit 32 të Ligjit, të përmbushen detyrimet, sipas këtij akti brenda afateve, si vijon:
 - (i) vazhdimisht, detyrimet e treguara në pikën 6 më sipër;
 - (ii) brenda 30 (tridhjetë) ditëve, detyrimet e treguara në pikat 1 dhe 2 më sipër;
 - (iii) brenda 45 (dyzet e pesë) ditëve, detyrimet e treguara në pikat 3 dhe 4 më sipër;
 - (iv) brenda një viti kalendarik, detyrimin e treguar në pikën 5 më sipër;

Afatet e sipërpërmendura fillojnë nga data e marrjes dijeni të këtij akti;

9. Kontrolluesi të njoftojë Komisionerin për masat e marra;
10. Në rast mospërmbushje të detyrimeve të parashikuara në këtë akt, Komisioneri vepron sipas pikës 2, të nenit 30 dhe nenit 39 të Ligjit, të cilët parashikojnë se në rast shkeljesh serioze, të përsëritura ose të qëllimshme të Ligjit nga një kontrollues ose përpunues, veçanërisht në rastet e përsëritura të moszbatimit të rekomandimeve të tij, Komisioneri vendos sanksione administrative për kundërvajtjet administrative përkatëse dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave.

Ky Rekomandim u shpall sot, më 25.02.2025.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi